



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Truly Nolen" Sh.P.K. të datës 31.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Truly Nolen" Sh.P.K. të datës 31.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 29.05.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Truly Nolen" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. prokurimi 616-24-4214-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë parashtruar dhe janë shqyrtuar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - *“Kërkesa 4. Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH, anëtari i grupit përkatësisht DDD SHPK nuk ka ofruar dëshmi se posedon lejën e importit për produkte biocide nga MMPH që është kusht për t'i përmbushur kërkesat tek Përshtatshmëria profesionale. Ju si Ak në vendimin e datës 29.05.2024 keni eliminuar dy grupet e Operatorve Ekonomik për të njejtën arsye se nuk posedojnë apo nuk kanë ofruar dëshmi në lidhje me kriterin: 7.1 dhe 7.2 të dosjes së tenderit përshtatshmëria profesionale”.*

- Lidhur me këtë pretendim ankimor është gjetur se pretendimi ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit të parashtruar si në vijim:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		4. Leja për importim të produkteve biocide nga MMPH	4. Kopje e Lejes për importim të produkteve biocide preparatet duhet të jenë konform lejës së importit.
		5. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018.	5. Kopja e certifikatave - valide dhe te noterizuara

- Nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se në ofertë është bashkangjitur një leje nga MMPH për liderin e GOE mirëpo jo edhe për anëtarin e GOE. Ndërsa certifikatat ISO janë dorëzuar nga të dy anëtarët e GOE mirëpo certifikatat ISO të anëtarit të GOE (DDD SHPK) janë me afat të skaduar. Përmes nenit 26.4 të RRPP është përcaktuar se *“Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se”*. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë ankimor është i bazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 2 - *“Poashtu tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë metodologjinë e punës, planin dinamik mbi realizimin e shërbimit (bazuar në specifikimin teknik në aneksin 1.), ku në aneksin 1 Ak ka kërkuar (deklarim me shkrim nga OE mbi realizimin e fazës brenda kohës së kërkuar), GOE nuk ka ofruar deklarim me shkrim mbi realizimin e fazës, mirëpo vetëm e ka cekur se periudha kohore e trajtimit është 19:30-23:30 dhe projekti është paraparë që të kryhet në 6 (gjashtë) faza me një interval kohor 7-14 ditë nga dita e përfundimit të fazës paraprake mirëpo nuk e ka cekur se për sa ditë do të kryhet një fazë që është në kundërshtim me aneksin 1”.*

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se ky pretendim ankimor i referohet kërkesë në DT të formuluar si në vijim:

4. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë metodologjinë e punës, planin dinamik mbi realizimin e shërbimit (bazuar në specifikimin teknik në aneksin 1.)	4. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë së punës.
--	--

- Nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti ka dorëzuar një dokument me titull *“Dezinsektimi hapësinor-Metodologjia”*. Por në të këtë dokument nuk është evidentuar askund planifikimi dinamik për realizimin e shërbimeve sipas aneksit 1 të DT. Prandaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 3 - "GOE të rekomanduar për kontratë kanë ofruar SDS dhe certifikatat e analizave të preparateve të ofruara, mirëpo preparatet me emër komercial MasterLine Aqua Kontrol 30-30 me materie aktive Permethrine, preparati me emër komercial Aquabac XT me materie aktive bacillus thuringiensis subspecies israelensis dhe Aquabac 200G me materie aktive bacillus thuringiensis subspecies israelensis mungojnë nënshkrimet në certifikatat e analizave".

- Lidhur me këtë pretendim ankimor është gjetur se nuk është kontestues fakti që janë dorëzuar dokumentet përkatëse por vetëm fakti nëse një pjesë e tyre janë nënshkruar ose jo. Lidhur me këtë aspekt është detyrim i komisionit për rivlerësim që të shqyrtoj nëse dokumentet si të tilla janë valide ose jo. Prandaj pretendimi ankimor është vetëm pjesërisht i bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.06.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.